

Zyra e Këshillimit të Karrierës dhe Alumnit, në bashkëpunim me Njësinë Bazë të Metodologjisë së Mësimdhënies zhvilluan një trajnim dyditor me temë: "Aftësitë Komunikuese dhe Bashkëpunimi për Shërbim Cilësor".

Qëllimi i aktivitetit ishte përforcimi i aftësive komunikuese dhe bashkëpunuese të studentëve duke i ndihmuar ata të zhvillojnë aftësi praktike për komunikim efektiv në situata të ndryshme profesionale. Synimi i trajnimit ishte të theksonte rëndësinë e bashkëpunimit, të përmirësonte punën në grup dhe të nxisë sjellje profesionale për ofrimin e një shërbimi cilësor. Trajnimi ofroi njohuri praktike diskutime interaktive dhe ushtrime konkrete që ndihmuan studentët të zhvillojnë aftësi efektive komunikimi dhe bashkëpunimi në situata profesionale.

Temat që u trajtuan:

- Roli i komunikimit verbal dhe joverbal në marrëdhëniet profesionale;
- Dëgjimi aktiv dhe menaxhimi i emocioneve gjatë komunikimit;
- Familjarizimi me konceptet, temat bazë të komunikimit dhe mënyrat e duhura të përdorimit të tyre;
- Aftësimi për zgjedhjen e mjeteve të përshtatshme komunikuese në varësi të situatës;
- Aftësimi për përgatitjen e prezantimeve verbale;
- Strategjitë për bashkëpunim të suksesshëm në mjedisin e punës;
- Karakteristikat e komunikimit strategjik;
- Publiciteti dhe komunikimi;
- Etika profesionale dhe sjellja bashkëpunuese;
- Koncepti i marrëdhënieve me publikun;
- Roli dhe detyrat e publicitetit;
- Aftësia për të prezantuar çështje në mënyrë efektive përpara audiencave të ndryshme;
- Ndikimi i komunikimit pozitiv në ofrimin e shërbimeve cilësore;
- Teknikat për zhvillimin e aftësive ndërpersonale në mësimdhënie dhe udhëheqje.

